



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr.1316/5 Prot.

Tiranë, më27/03/2018

V E N D I M

Nr.19 Datë 27/03/2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË ADMINISTRATËN E ZONAVE TË MBROJTURA, QARKU SHKODËR, "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË AKTIVITETIN EKONOMIKO-FINANCIAR, MONITORIMIN DHE MBROJTJEN E MJEDISIT ”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtori i Përgjithshëm. Në opinionin e grupit të auditimit, konstatohet se nga subjekti i audituar ka devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi(kriteret) dhe ka mungesë të theksuar të efektivitetit për masat e marra në fushën e administrimit dhe menaxhimit të këtyre Zonave të Mbrojtura, krijimit të ardhurave dhe financimit të tyre. Në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin e përputhshmërisë në aktivitetin ekonomiko-financiar dhe monitorimin në fushën e mjedisit*”, të ushtruar në AdZM Shkodër, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. Konkluzione dhe opinionin i auditimit

| |
|--|
| |
|--|

Nga auditimi e kryer për përputhshmërinë në subjektin: *Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër*, mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, u konstatuan devijime jo materiale dhe nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

-Rekrutimi për punësim, përshkrimi i vendeve të punës dhe emërimi i punonjësve të Administratës së Zonave të Mbrojtura Shkodër, nuk është bërë bazuar në kriteret apo kërkesa specifike të nevojshme për përputhshmërinë e vendit të punës, me cilësitë dhe me arsimin e punonjësve të emëruar, kriteret dhe kërkesa këto që duheshin miratuar nga Ministri i linjës – AKZM.

-Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura rezultoi se nga 3 Zona të Mbrojtura, janë hartuar planet e menaxhimit vetëm Zonës së Mbrojtur të liqenit Shkodër.

- Mos zgjidhja e problemeve që ka në liqenin e Shkodrës, ku OMP që është subjekt privat ka kryer liçensimin e e peshkatarëve pa u kryer studimi paraprak, pa respektuar e marrë në konsideratë veçoritë e statusit si Zonë e Mbrojtur dhe si zonë Ramsar ka sjellë pasojë për mbrojtjen e kësaj zone. Numri i lartë i liçensave të dhëna pa u respektuar kriteret e mësipërme, peshkimi i paligjshëm, kanë reduktuar ndjeshëm rezervën peshkore në liqen, e cila ndikon drejtpërdrejt në praninë ose jo të shpendëve ujorë dimëruar.

-Liqeni i Shkodrës ka nivele të larta ndotje të krijuara nga: derdhja e ujrave të zeza të qytetit të Shkodrës në grykëderdhje të lumit Drin dhe Bunë, hedhja e mbetjeve urbane, depozitimi dhe grumbullimi në breg të liqenit i inerteve nga ndërtimet pa leje dhe ndërtimi i Bypass-it të Shkodrës, si dhe ndotja ndërkuftare që krijohet nga shkarkimi i mbetjeve kimikate të kombinatit të Aluminit në Malin e Zi.

-Për Parkun Kombëtar të Thethit nuk ka të dhëna për ndërtimet pa leje dhe aktivitetet e biznesit, nuk ka evidentim të dëmtimeve të parcelave pyjore e kullotave të Zonës së Mbrojtur dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për mungesë të dhënash dhe administrim sipas kërkesave ligjore. Nuk ka përlllogaritje të dëmeve, që janë kryer në këtë zonë dhe nuk është kërkuar në asnjë rast zhdëmtimi dhe përmirësimi i tyre.

- Ka munguar vlerësimi i duhur nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, për krijimin e të ardhurave nga Zonat e mbrojtura, pasi nuk janë miratuar tarifa për shërbimet që kryhen për vizitorët në pikat turistike dhe monumentet natyrore me vlera historike dhe kombëtare. Gjithashtu, ka munguar infrastruktura për ngritjen dhe funksionimin e pikave të kalimit të vizitorëve, pasi ka disa rrugë hyrëse të pakontrollueshme në një pikë turistike. Ministria e Mjedisit dhe Turizmit nuk ka zgjidhur problemin e vendosjes së infrastrukturës dhe tarifave të nevojshme, gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për realizimin e të ardhurave, si detyrim i AdzM-ve që menaxhojnë zonat e mbrojtura.

-Ka munguar bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Aluizni-t Qarku Shkodër për evidentimin e ndërtimeve pa leje në territorin e Zonave të Mbrojtura, mungon korrespondenca zyrtare me ZRPPP- të, njësitë e vetëqeverisjes vendore e strukturave të tjera përkatëse, për saktësimin dhe azhurnimin e përditësimin e të dhënave, përpunimin e hartave të shtrirjes dhe zonimit sipas kategorive, si dhe përcaktimin e kufijve të zonave dhe territoreve në pronësi apo në përdorim të njërive të vetëqeverisjes vendore.

** Në lidhje me certifikimin ose jo, sqarojmë se nuk mund të certifikojmë aktivitetin e AdzM Shkodër, pasi mungon baza e të dhënave materiale e financiare për të kryer një certifikim objektiv, profesional e të mbështetur në të dhëna të pakontestueshme, për shkak se 90 % e materialitetit gjendet në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura(AKZM).*

Lloji i opinionit të grupit të auditimit: Opinion mohues

Në lidhje me çertifikimin ose jo të aktivitetit të subjektit AdzM Shkodër, opinioni i grupit auditimit është mohues nuk mund të çertifikojmë, pasi e kemi patur të pamundur të merrim evidenca të mjaftueshme materiale e financiare, për të kryer një çertifikim objektiv, profesional e të mbështetur në të dhëna të pakontestueshme, për shkak se 90 % e këtyre pasqyrave gjenden në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura(AKZM) Tiranë.

Drejtoria Rajonale e Administrimit të Zonave të Mbrojtura ka devijime jo materiale nga kuadri ligjor rregullator në fuqi dhe ka mungesë të theksuar të efektivitetit, për masat e marra në fushën e administrimit dhe menaxhimit të këtyre Zonave të Mbrojtura, krijimit të të ardhurave dhe financimin e tyre. Është konstatuar se ka mungesë të theksuar bashkëpunimi me organet e pushtetit vendor, institucionet ligjzbatuese rang Qarku(Polici rendi, bashkiake, IKMTV, etj.) e OJF-të në fushën e mjedisit e peshkimit, nuk ka patur një orientim të duhur profesional, teknik e menaxhues nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si organ direkt përgjegjës për mirëmenaxhimin dhe administrimin e ZM dhe mbështetjen e tyre teknike e financiare, etj.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e VKM nr. 430 datë 23.07.2016 “Për bashkë menaxhimin e Ujërave të Brendshme të Liqenit të Shkodrës”, nuk janë përgatitur dhe nxjerrë udhëzimet përkatëse për përcaktimin e aktorëve pjesëmarrës dhe procedurave që duhen ndjekur për peshkimin në kuadër të menaxhimit të ujërave burime natyrore. Kështu, funksionimi i inspektimit të peshkimit në ZM, nuk është i rregulluar apo mbështetur me bazën ligjore të nevojshme. Kjo, duhet të përcaktohet e rregullohet nga Ministria e Turizmi dhe Mjedisit. Ndërsa në kontratën e lidhur në mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit(OMP), është parashikuar që inspektimin e kryen me mjetet e veta Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, gjë e cila është në konflikt interesi, pasi kjo organizatë nuk mund të kontrollojë aktivitetin e vet. Përjashtimi nga kjo kontratë(marrëveshje) e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, konkretisht të AdZM Qarku Shkodër, ka sjellë mungesën e kontrollit dhe mos parandalimin e peshkimit të paligjshëm. Është shmangur roli mbrojtës i AdZM Qarku Shkodër për ruajtjen e liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna, si pjesë e rëndësishme e Zonës së Mbrojtur. Problemet në liqenin e Shkodrës janë krijuar nga OMP, e cila është subjekt privat dhe ka kryer liçensimin e peshkatarëve pa asnjë lloj studimi paraprak, pa vlerësuar rëndësinë dhe përgjegjësinë që ka për statusin e liqenit të Shkodrës, si zonë e mbrojtur dhe zonë Ramsar. Numri i lartë i liçensave të dhëna pa kriter dhe peshkimi i paligjshëm, kanë reduktuar ndjeshëm rezervën peshkore në liqen, e cila ndikon drejt për drejt në praninë ose jo të shpendëve ujore dimërues. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 34 i ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” datë 04.05.2017.

Rekomandim për përmirësim ligjor: AdZM të kërkojë dhe të nxisë në AKZM dhe Ministrinë Mjedisit dhe Turizmit paraqitjen së kërkesës për bashkëpunim dhe mirëkuptim me Ministrinë e Bujqësisë, duke ekspozuar problematikën që ka krijuar kjo situatë, si dhe të hartohet marrëveshje e përbashkët për kontrollin e ruajtjen e zonave të ndaluara për peshkim dhe parandalimin e peshkimit të paligjshëm në Liqenin e Shkodrës dhe grykëderdhjen e lumit të Bunës, si pjesë të Zonës së Mbrojtur Qarku Shkodër.

2. Gjetje nga auditimi: Kontributi i AdZM për vjeljen e të ardhurave nëpërmjet tarifave si një prioritet i punës së saj është në vlera minimale, kjo për arsye se nuk është plotësuar me akte administrative. Janë arkëtuar të ardhura vetëm nga dy kontrata të përkohshme 2 mujore për ngritje kampingu nga 2 shoqata bamirësie. Ndërsa, nga Ministria e linjës dhe AKZM, nuk janë miratuar tarifatat për vjeljen e të ardhurave për vizitorët në pikat turistike, duke lejuar përdorimin pa kriter e pagesë të vlerave të monumenteve natyrore me vlera historike dhe kombëtare, të ardhura këto që do të përdorehin për mirë administrimin e tyre. Gjithashtu, ka munguar

infrastruktura për ngritjen e pikave të kalimit të vizitorëve, pasi ka disa rrugë hyrëse të pakontrollueshme në një pikë turistike. Nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit, megjithëse e ka patur detyrim ligjor, nuk e ka zgjidhur problemin e vendosjes së infrastrukturës së nevojshme dhe gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për rritjen e të ardhurave. Mos marrja e masave nga institucionet që menaxhojnë Zonat e Mbrojtura, janë në kundërshtim me VKM nr.102 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, Kreu III, pika 2, me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, neni 17, pika 4, ku përcaktohet : *“Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore” dhe neni 57 “Burimet e financimit dhe administrimi”, pika 4, ku citohet: “Me propozim të AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to”.*

Rekomandim: AdZM Shkodër në bashkëpunim me AKZM Tiranë:

- a. Të kërkojë pranë Ministrisë Mjedisit dhe Turizmit, marrjen e masave për caktimin dhe vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të Mbrojtura, duke realizuar një ndikim pozitiv në mirëadministrimin e tyre në të ardhmen.
- b. Të marrë masa dhe të bashkëpunojë në hartimin e projekt-drafteve administrative për miratimin e tarifave vizitore, që do të përdoren për vjeljen e të ardhurave nga turistët vizitorë të ZM-ve, si një masë pozitive në rritjen e menaxhimit të këtyre pasurive publike me vlera të mëdha natyrore, historike dhe shëndetësore.

3. Gjetje nga auditimi: Në zonat e mbrojtura ka shumë individë privat, që janë banorë të zonës dhe biznesesh, subjekte private e shoqata që ushtrojnë aktivitete tregtare, turistike e kurative, duke shfrytëzuar resurset e këtyre burimeve natyrore fitimprurëse. Nga AdZM nuk ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si; bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive, shërbimet turistike dhe kurative, etj. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetit, lejet mjedisore, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9, pika 5, i ligjit nr. 8906, date 6.6.2002 “Per Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar. Nga Qeveria qendrore dhe Njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk është zgjidhur problemi i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre

Rekomandim : AdZM Shkodër në bashkëpunim me AKZM Tiranë të kërkojë pranë Ministrisë Mjedisit dhe Turizmit për bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Njësitë e vetëqeverisjes vendore, vendosjen e taksave specifike për shfrytëzimin e peisazhit natyror të ZM, siç janë bizneset shëndetësore(kuruese), biznese që kanë lidhje me florën e faunën me qëllime argëtuese, etj., duke i bërë pjesë të paketës fiskale të Qeverisë apo Bashkive, si burim të ardhurash për AKZM dhe AdZM rajonale krijimin e mundësive financiare për krijimin e fondeve për mirëmbajtjen dhe ushtrimin e funksioneve të monitorimit e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

4. Gjetje nga auditimi: Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna kanë një sipërfaqe prej 49562 hektarë si zonë e mbrojtur natyrore dhe mbështetur në të dhënat e raporteve të menaxhimit e monitorimit të AdZM Shkodër për projektet që veprojnë në këtë zonë, është konstatuar se ka nivele të larta ndotjeje, të cilat kanë ndikuar në cilësinë e ujit dhe të ajrit dhe kanë ndikim negativ në florën dhe faunën e ZM-ve, ardhur nga:

- a. Ujërat e zeza të prodhuara nga qyteti i Shkodrës me mbi 140 mijë banorë, të cilat shkarkohen në ujërat e lumenjve Drin dhe Bunë pa u përpunuar, kanë sjellë si pasojë një situatë të tejndotur

në nivelet të larta sëmundshmërie infektive. Nga bashkia Shkodër nuk është dhënë zgjidhje për këtë situatë me arsyetimin se kemi mungesë fondesh dhe për këto projektet e mbetura pa u përfunduar.

b. Mbetjet urbane, ndërtimore, mbeturina të ndryshme ndodhen përgjatë gjithë bregut të këtij liqeni, si dhe barishte të shumta kanë dalë në sipërfaqe të ujit, të cilat kanë ndikuar edhe në uljen e numrit të pushuesve gjatë sezonit të verës, ndryshe nga shume vite më parë, kur liqeni në zonën e Shirokës dhe Zogaj ishte ndër zonat më të frekuentuara të qytetit të Shkodrës.

Nuk ka asnjë studim për të vlersëuar shkallët e dëmtimit të aluvioneve në Liqenin e Shkodrës, shpërndarjen e tyre gjeografike, ndikimin që kanë ato në sistemin hidrik, karstik dhe në zgavrat nënujore si dhe shkallët e dëmtimit të potencialit hidrik të Qarkut Shkodrës.

c. Ndërtimet e panumërta me leje dhe pa leje dhe ndotja kimike, e cila është edhe më e dëmshme, janë faktorët që po shkatërrojnë faunën dhe biodivesrsitetin e liqenit të Shkodrës dhe grykëderdhjen e lumit Buna.

d. Një nga burimet e ndotjeve të liqenit Shkodër është kombinati i Aluminit në Malin e Zi, i cili derdh mbetjet e kimikateve në lumin Moraça, dega kryesore e furnizimit me ujë për liqenin e Shkodrës. Ky lum që ka prurje 200 metër kub në sekondë, i transporton mbetjet kërcënuese për liqenin nga Mali i Zi deri në Shkodër. Ky është një ndër problemet kryesore të ngritura nga ambientalistët për ndotjet kimike që krijohen nga shkarkimet e fabrikës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për Zonat e Mbrojtura” neni 9 pika 2/b, neni 10 pika 3. me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.20217 “Për zonat e mbrojtura” neni 25 “Zonë e mbrojtur ndërkufitare” pika 1,2/a,b dhe neni 26.

Rekomandim: AdZM dhe AKZM në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në rolin e autoritetit të mbrojtjes dhe menaxhimit të ZM:

a. Të bashkërendojnë punën për hartimin e programeve dhe zgjerimin e rrjetit të monitorimit.

b. Të marrin masa dhe të propozojnë hartimin e një plani masash konkrete për parandalimin e ndotjeve dhe hartimin e marrëveshjeve të brendshme dhe marrëveshjet e përbashkëta me fqinjët, për eliminimin e faktorëve që ndikojnë në dëmtimin e ekosistemit të liqenit të Shkodrës dhe grykëderdhjen e lumit Buna, duke bërë të mundur rritjen e aplikimeve për përfitimin nga projektet e ofruara nga donatorë të ndryshëm dhe nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

5. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në të dhënat e AdZM Shkodër, Parku Kombëtar i Thethit ka patur një numër të kufizuar të turistëve në krahasim me zonat e tjera të Alpeve, për arsye të mungesës e infrastrukturës optimale të turizmit. Nga banorët vendas janë ngritur bujtina të reja, si dhe shfrytëzohen bujtinat e vjetra tradicionale për pritjen e vizitorëve, por këto janë të kufizuara. Këto aktivitete biznesi turistik në pjesën më të madhe nuk janë të licencuara dhe nuk kanë marrë leje mjedisore. Për këto veprimtari AdZM Shkodër, nuk disponon të dhëna të plota dhe mungon bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe institucionet tatimore, për të bërë të mundur gjetjen e rrugëve për krijimin e të ardhurave nga shfrytëzimi që bëhet nga persona fizik e juridik të peizazhit të monumenteve natyrore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe vlerat historike të ZM. Ndërtimi i këtyre bujtinave është i pakontrolluar, pasi për zonën që i përket Bashkisë Malësisë së Madhe, nuk ka plan rregullues apo zhvillimor. Shumë ndërtime në këtë park kombëtar janë ndërtuar pa leje të KKRTT-së Shqipërisë. Nuk ka evidentim të dëmtimeve të parcelave pyjore e kullotave të ZM, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për to, nuk ka përlllogaritje të dëmit, si dhe nuk është kërkuar në asnjë rast zhdëmtimi dhe përmirësimi i tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura” neni 9 pika 2 dhe me nenin 30 “Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura” të rregullores së të brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKZM dhe ADZM të miratuar me datë 21.09.2015 dhe me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.20217 “Për zonat e mbrojtura” Kreu X “Inspektimi dhe sanksionet” neni 68 pika 2, neni 67 dhe 69

Rekomandim: AdZM Qarku Shkodër të marrë masa dhe të rrisë bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për reklamimin dhe vënien në efikasitet të vlerave turistike të këtij Parku

kombëtar si burim të ardhurash, duke e mbrojtur nga dëmtimet si; prerjet dhe gjuetia e paligjshme, dëmtimet nga zjarret në pyje dhe kullota, ndalimin e ndërtimeve pa leje, etj. Të bashkërendojë punën për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e Parkut Kombëtar Theth me ISHMP, IKMV, Bashkinë e Malësisë Madhe, institucionet e dhënies të licencave, PMNZSH, Policinë e Shtetit, etj., duke evidentuar dhe ngritur sistemin e të dhënave të personave fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet në këtë ZM, rritjen e kontrolleve të befasishme dhe denoncimin e rasteve të shkeljeve ligjore pranë organe shtetërore përkatëse.

6. Gjetje nga auditimi :

-Nuk është bërë analizë faktoriale në mënyrë të detajuar nga AdZM Qarku Shkodër në fund të çdo viti, megjithëse është përgatitur raporti i menaxhimit të qëndrueshëm të zonës së mbrojtur, në të cilin kanë paraqitur gjendjen e ZM dhe problematikave të dala.

-Nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet pergjegjëse.

-Mungon mbështetja institucionale në nivelin e Ministrisë së linjës, për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënies të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. Këto raporte janë dërguar pranë AKZM në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, por nuk publikohen dhe nuk i janë dërguar Bashkisë Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 30 “Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura” të Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKZM dhe ADZM të miratuar me datë 21.09.2015 nga Ministri.

Rekomandim: AdZM në bashkëpunim me AKZM të marrë masa që raportet vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së ZM, të trajtohen në mënyrë sa më të detajuar për problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masat për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre. Këto raporte të bëhen publike dhe të bëhen të njohura dhe Bashkisë Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë, duke patur transparencë në prezantimin e punës dhe problemeve që kanë ZM dhe që i shërbejnë ruajtjes së ekosistemit të këtyre NJVQV-ve.

7.Gjetje nga auditimi: Në zonat e mbrojtura të Qarkut Shkodër, flora dhe fauna është e kërcënuar për vete faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banorësh, të cilët me aktivitetin e tyre po cenojnë këto vlera, si dhe po dëmtojnë biodiversitetin. Ka tendenca të njerëzve për gjueti të paligjshme, prerje të paligjshme apo aktivitete që bien ndesh me planet apo draft-planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Mungojnë nga AdZM, propozimet për zbatimet e masave dhe programeve për ripërtëritjen e mjedisve në zona të mbrojtura, të cilat janë dëmtuar, shkatërruar dhe të degraduar. Problematikat janë konstatuar e evidentuar nga grupi i auditimit nga vlerësimi i raporteve periodike që kanë dorëzuar punonjësit në përfundim të shërbimit ditor e javor .

Rekomandimi: AdZM në bashkëpunim me ISHMP Qarku Shkodër, të marrin masa dhe të rritin bashkëpunimin institucional, për monitorimin, konstatimin dhe procedimin ligjor të personave apo subjekteve që shkelin ligjin dhe që dëmtojnë Zonat e Mbrojtura, si dhe:

a. Të ngrejë grupe të përbashkëta pune(Task force) në mënyrë periodike dy mujore dhe për çdo kontroll të kryer në terren të merren masa për rastet e flagrancës, duke dokumentuar e ndëshkuar rastet e kundravajtjeve administrative dhe shkeljeve ligjore.

b. Të marrin masa për rritjen e bashkëpunimit me organet e tjera ligjzbatuese në Qarkun e Shkodrës: Policinë e Shtetit, Policinë bashkiake, IKMV,etj. në bashkitë respektive dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare.

8. Gjetje nga auditimi: AdZM Shkodër nuk ka të evidentuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Shkodër, të cilat duhet të ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga auditimet e

ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Aluizni-t Shkodër, kanë rezultuar se janë legalizuar objektet në **15 raste**, të cilat janë aktualisht brenda zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodrës dhe në 3 raste janë legalizuar brenda zonës së mbrojtur të lumit Buna. Këto legalizime ishin bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës dhe lejes mjedisore të aprovuar në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, neni 19 “Përdoruesit e zonave të mbrojtura”, neni 25 “Veprimtaritë në zonat e mbrojtura”, si dhe VKM nr. 684, datë 2.11.2005 “Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar” .

Rekomandim: AdZM Shkodër në bashkëpunim me AKZM Tiranë të veprojë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Policinë bashkiake dhe IKMTV, për marrjen e të dhënave për ndërtimet informale dhe të kryeje verifikimin e tyre në terren. Gjithashtu, të vendosi korrespondencë zyrtare me ALUIZNI-n dhe ZRVPP Shkodër, Malësi e Madhe e Pukë, për shkëmbimin e informacionit për të ndaluar legalizimin e ndërtimeve informale të shtrira në ZM, veçanërisht për ato ndërtime që janë në proces legalizimi ose hipotekimi, bërjen e kërkesave për prishjen e tyre si ndërtime të paligjshme.

9. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të politikave, strategjive e programeve të Qeverisë në fushën e zonave të mbrojtura dhe ruajtjes së natyrës me mbështetje të ish-Ministrit të Mjedisit, në kuadër të projekteve të huaja nga shoqata të ndryshme, në partneritet me institucione dhe ekspertë akademikë, janë hartuar planet e menaxhimit afatmesëm për e zonat e mbrojtura, për të cilat mungojnë kostot preventive, por janë miratim si kërkesa të ligjit përkatës:

a. Parkun Kombëtar Theth kategoria e katërt, kjo sipas kriterëve të IUCN shpallur me VKM Nr. 96 datë 21.11.1966 me sipërfaqja është 2630 ha.

b. Rezervati Natyror i Menaxhuar i Liqenit të Shkodrës kategori e katërt sipas kriterëve të IUCN shpallur me VKM 684, datë 02.11.2005, me **sipërfaqe 26 535 Ha.**

c. Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur, (lumi Buna –Velipojë) i kategori e pestë, sipas kriterëve të IUCN shpallur me VKM 682 datë 02.11.2005 me sipërfaqe 23 027 ha. Është miratuar ”Plani i Menaxhimit të Rezervatit Natyror të Menaxhuar të Liqenit të Shkodrës 2013-2016”, ndërsa dy të tjerat nuk janë miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ndryshuar neni 15,16 dhe me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni .

Rekomandim: AdZM Shkodër në bashkëpunim me AKZM të kërkojnë pranë Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit, përshtetimin e miratimit të planeve të menaxhimit të hartuar për zonat e mbrojtura, për sigurimin e ruajtjes dhe mirëmenaxhimit të tyre, duke zbatuar rregullat dhe planet nga të gjithë aktorët që janë pjesë e këtij plani dhe shfrytëzojnë burimet natyrore dhe vlerat kulturore, historike dhe shëndetësore të ZM Qarku Shkodrës.

10. Gjetje nga auditimi: AdZM në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Shkodër, kanë hartuar database-n e kadastrës me të dhënat e viteve 1980 për nënzonat e ZM-ve, me emërtimin ekonomi pyjore-kullosore Dajç, Velipojë, Shalë dhe Ana e Malit. Në këto database janë përfshirë këto elementë: sipërfaqet, kodi kadastral, emërtimi, vendodhja në NJVQV, kategorizimi, akti ligjor i shpalljes, statusi dhe situata e inventarizimit. Në këtë database nuk ka të dhëna për sipërfaqet ujore. Gjithashtu regjistri elektronik i AdzM Qarku Shkodër nuk është i përditësuar, pasi nuk ka të azhurnuar të dhënat për ndryshimet e ndodhura në sipërfaqet territoriale nën juridiksionin administrativ. Nuk ka përpunim të hartave të territoreve dhe zonimit e brendshme. Nuk ka të dhëna për ekosistemet pyjore, që do të inventarizohen dhe mbarështohen, për përditësimin periodik të inventarit kombëtar të pyjeve, për hartografinë dhe digjitalizimin e njësive të mbarështimit .

Rekomandim: AdZM me mbështetjen e AKZM-së të bashkërendojë punën dhe të krijojë korespondencë zyrtare me ZRVPP-të, Njësitë Vetëqeverisjes Vendore e strukturat e tjera përkatëse, për saktësimin dhe azhurnimin e përditësimeve të dhënave për sipërfaqet e ZM-ve

në Qarkun Shkodër, duke kryer përpunimin e hartave të shtrirjes dhe zonimit sipas kategorive, përcaktimin e kufijve të zonave dhe territoreve në pronësi apo në përdorim të njësive vetëqeverisjes vendore, etj.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Vërejtje me paralajmërim”**, për këta punonjës:

1. **A.D**, me detyrë Drejtor i AdzM Shkodër,
2. **T.M** me detyrë Përgjegjës i sektorit të menaxhimit,
3. **F.B** me detyrë Përgjegjës i sektorit të menaxhimit,
4. **A.M** me detyrë specialiste për florën dhe ekosistemin.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në menaxhimin dhe administrimin e territorit të Zonave të Mbrojtura Shkodër.

C. INDICIE PËR AUDITIM

Mbështetur në vlerësimin e funksionimit të strukturës së ngritur për AdzM Shkodër dhe kompetencave në raport me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, veçanërisht në mënyrën e shpërndarjes së përgjegjësive drejtuese e menaxhuese, përqëndrimin të funksioneve kryesore në AKZM Tiranë të menaxhimit financiar, drejtimit ekonomik e kryerjes së pagesave për të gjithë aktivitetet ekonomiko - mjedisor, zbatimin të projekteve me fonde të buxhetit të shtetit ose donatorë të huaj, **mendoj që të kryhet auditim përputhshmërie e rregullshmërie në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Tiranë dhe shtrirjen sipas problematikave me objekt tematik në AdzM e Qarqeve.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, si dhe Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R